



Prishtinë: 29 dhjetor 2009

Kodi i ZRRE-së: V\_218\_2009

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:**

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të sistemit të Transmisionit të datës 04 dhjetor 2009,  
**në seancën e mbajtur më 29 dhjetor 2009 ka nxjerrë këtë:**

## VENDIM

1. **I lejohet KOSTT SH.A.** derrogimi në zbatimin e dispozitave të disa neneve të **Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të sistemit të Transmisionit** si në Shtojcë të këtij vendimi.
2. Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.

## ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04 dhjetor 2009 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të sistemit të Transmisionit, së bashku me raportin e neneve për derrogim, si dhe raportin e korrigjuar me datë 11 dhjetor 2009. Pas vlerësimit të kërkesës, dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të sistemit të transmisionit, ZRrE ka parë të arsyeshme që të lejojë derrogimin në afatet e vendosura si në shtojcë. Derrogimi përfshinë afatet nga data e aplikimit apo skadimit, dhe vlen gjer me datën e vendosur në raport në kolonën "Periudha deri kur vlen Derrogimi".

1. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
2. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

4. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca – “091204\_KOSTT\_Raporti i Derogimeve\_Kodi i Rrjetit\_Licenca OST\_Lejuar”;

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

---

Përparim Kabashi, Anëtar

---

Blerim Koci, Anëtar